



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2025:015908

Datë: 26.02.2025

Numri i dokumentit: 06907940

PPP.nr.1/2025

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Berkan Hamza, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të përmbarimit, sipas propozimit për përmbarim të kreditorës së përmbarimit Gj, me seli në Gjakovë, rruga “....., të paraqitur kundër debitorit të përmbarimit Q.A.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 1,148.73 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me ujë të pijshëm, lejuar me urdhrin për përmbarim, P.nr.2254/24 të datës 06.12.2024, të përmbaruesit privat Gj.R nga Gjakova, duke vendosur sipas propozimit të debitorit të përmbarimit, jashtë seancës më datën 26.02.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET PJESERISHT I BAZUAR propësimi i debitorit përmbarimit Q.A.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, dhe Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.2254/24 të datës 06.12.2024, në shumë prej 963.09 euro, SHFUQIZOHET, i paraqitur kundër urdhrin të përmbaruesit privat Gj.R, me të cilin është caktuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit Gj, në bazë të dokumentit të besueshëm faturës, lidhur me pagimin e borxhit në shumën prej 1,148.73 euro.

II. REFUZOHET pjesërisht i pabazuar propësimi i Q.A.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, MBETET NË FUQI urdhri i përmbaruesit privat Gj.R, P.nr.2254/24 të datës 06.12.2024, për pjesën e borxhit në shume prej 185.64 euro, me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së propozimit (06.12.2024) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi Urdhërohet që në afatin prej 7 ditësh nga dita e parashtrimit të ankesës, të paguaj garancinë në gjykatë në shumë prej 185.64 euro.

IV. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Organi i përmbarrimit, përmbarruesi privat Gj.R nga Gjakova, me urdhrin për përmbarrim, P.nr.2254/24 të datës 06.12.2024, ka lejuar propozimin për përmbarrim të kreditores së përmbarrimit, Gj, me seli në Gjakovë, të paraqitur kundër debitorit të përmbarrimit Q.A.H nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, për përmbarrimin e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat e kontabilitetit, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 1,148.73 euro, në emër të shpenzimeve komunale për furnizim me ujë të pijshëm për periudhën kohore nga data 01.06.2010 deri më datën 08.11.2024.

Kundër këtij urdhri për përmbarrim, pas pranimit të tij, debitori ka ushtruar prapësim, më gjerësisht si në arsyetimin e këtij prapësimi, ndërsa pas pranimit të prapësimit nga pala kreditore, ka parashtruar përgjigje në prapësim, më gjerësisht si në përgjigjen në prapësim.

Në propozimin për përmbarrim të datës 06.12.2024, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Gj.R në Gjakovë me Urdhrin P.nr.2254/24 të datës 06.12.2024, në bazë të dokumentit të besueshëm, ekstrakti nga librat e kontabilitetit nga kreditori është kërkuar borxhi për periudhën nga data 01.06.2010 deri me datë 08.11.2024.

Sa i përket borxhit për periudhën prej datës 01.06.2010 e deri më datën 31.12.2022, gjykata gjeti se për këtë periudhë kohore për borxhin në shumën prej 963.09 euro ka arritur parashkrimi sepse në nenin 360 par.1 të LMD-së parashihet që *“1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa kreditori propozimin për përmbarrim e ka parashtruar më datë 06.12.2024. Ky borxh sipas vlerësimit të gjykatës është parashkruar pasi që afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë dhe se parashkrimi i borxhit për vitin 2010 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2010 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2011, parashkrimi i borxhit për vitin 2011 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2011 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2012, parashkrimi i borxhit për vitin 2012 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2012 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2013, parashkrimi i borxhit për vitin 2013 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2013 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2014, parashkrimi i borxhit për vitin 2014 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2014 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2015, parashkrimi i borxhit për vitin 2015 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2015 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2016, parashkrimi i borxhit për vitin 2016 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2016 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2017, parashkrimi i borxhit për vitin 2017 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2017 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2018, parashkrimi i borxhit për vitin 2018 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2018 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2019, parashkrimi i borxhit për vitin 2019 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2019 dhe është parashkruar

pas një viti, përkatësisht 31.12.2020, parashkrimi i borxhit për vitin 2020 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2020 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2021, parashkrimi i borxhit për vitin 2021 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2021 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2022, parashkrimi i borxhit për vitin 2021 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2021 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2022, si dhe parashkrimi i borxhit për vitin 2022 ka filluar të rrjedh nga 31.12.2022 dhe është parashkruar pas një viti, përkatësisht 31.12.2023. Duke marr parasysh faktin se propozimi për përmbarim është parashtruar me datë 06.12.2024, gjykata vlerëson se borxhi i krijuar për periudhën prej datës 01.06.2010 e deri më datën 31.12.2022, në shumën prej 963.09 euro ka arritur parashkrimi, andaj për këto arsye, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Debitori gjatë viteve 2023 dhe deri me datën 08.11.2024, në bazë të ekstraktit nga librat e kontabilitetit, ka shfrytëzuar shërbimet e debitorit në vlerë prej 185.64 euro, kurse i njëjti për këtë periudhë nuk ka bërë pagesa fare, andaj borxhi i mbetur për vitin 2023 dhe deri me datë 08.11.2024 është në vlerë prej 185.64 euro, të cilën borxh debitori është i detyruar ta paguaj sepse për këtë borxh nuk ka arritur parashkrimi, pasi që afati i parashkrimit për borxhin e vitit 2023, fillon të rrjedh nga fundi i vitit, dhe se afati 1 vjeçar i parashkrimit do të arrinte me 31 dhjetor 2024, kurse për borxhin e vitit 2024, parashkrimi nuk rrjedh sepse propozimi për përmbarim është lejuar me datë 06.12.2024, e me këtë është ndalur rrjedha e parashkrimit. Debitori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi me të cilën vërtetohet se është përmbushur detyrimi sipas dokumentit të besueshëm, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 69 paragrafi 4 të LPP-së i cili shprehimisht përcakton se: *baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*, Andaj gjykata e refuzoi prapësimin e debitorit për pjesën e borxhit për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri me datën 08.11.2024, në shumë prej 185.64 euro.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimin.*

Gjykata vendosi që ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe ta lërë në fuqi urdhërin e përmbaruesit privat, e duke u bazuar në nenin 29 par.1 nën par.3 të LPP-së, ku ndër të tjera është cekur: *Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji, ndër të tjera, është edhe fatura, e po ashtu në paragrafin 3 të këtij neni është cekur: Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe së në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.*

Andaj nga të cekurat më lartë, e në kuptim të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2025:015908
Datë: 26.02.2025
Numri i dokumentit: 06907940

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.1/2025, më 26.02.2025

Gjyqtari
Berkan Hamza

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.